



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Kategoritë e Aseteve dhe Jetëgjatësia e Aseteve

Përgjigje ndaj komenteve

Shqyrtimi periodik i vlerave hyrëse për OST/OT-në dhe
OSSH-në

(2018-2022)

DEKLARATË

Ky Raport i Përgjigjeve është përgatitur nga ana e ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit të sektorit të energjisë. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si i tillë.

4 prill 2018



Përmbajtja

1	Hyrje	1
2	Jetëgjatësia dhe kategoritë e Aseteve të OSSH.....	2
2.1	Përmbledhja e komenteve të KEDS-it.....	2
2.2	Përmbledhja e komenteve të KOSTT-it.....	3
3	Pozicioni i ZRRE-së për komentet e KEDS-it	3
3.1	Jetëgjatësia e asetëve të Tensionit të Ulët	3
3.2	Jetëgjatësia e asetëve të njehsorëve dhe pajisjeve matëse	3
3.3	Jetëgjatësia e asetëve të pajisjeve dhe orendive për zyre	4
3.4	Jetëgjatësia e asetëve të pajisjeve të TI.....	4
3.5	Rishikimi i jetëgjatësisë së asetëve ekzistuese	4
4	Pozicioni i ZRRE-së për komentet e OST/OT	4
5	Propozimi i Jetëgjatësisë dhe kategorizimit të asetëve për OST/OT dhe OSSH.....	5



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është duke kryer Shqyrtimin Periodik për periudhën e dytë Rregullative (PRR2) për të përcaktuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), Operatorin e Tregut (OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për periudhën 1 prill 2018 deri 31 mars 2023. KOSTT SH.A. kryen aktivitetet e OST/OT, ndërsa KEDS SH.A. të OSSH-së. Të hyrat e lejuara aktuale u përcaktuan për Shqyrtimin e parë Periodik 2013-2017 në vitin 2013 (PRR1).

Si pjesë të këtij shqyrtimi, ZRRE-ja do të përcaktoj paraprakisht një numër të vlerave hyrëse për llogaritjen e MAR në mënyrë që të siguroj kohë të mjaftueshme për konsultimin publik të tyre. Kjo është praktika e njëjtë që është zbatuar për PRR1. Vlerat hyrëse në fjalë janë:

- Niveli fillestar dhe norma e pritur e reduktimeve të humbjeve në Sistemin e Transmetimit dhe Shpërndarjes.
- Norma e pritur e efikasitetit në kostot operative të OST/OT-së dhe OSSH.
- Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (WACC) të OST/OT-së dhe OSSH, që është subjekt i këtij Raporti të Përgjigjeve.
- **Jetëgjatësia e aseteve që do të përdoret për qëllime të llogaritjes së zhvlerësimit rregullativ të investimeve të reja.**

ZRRE-ja ka publikuar Raportin Konsultativ me propozimet e veta për jetëgjatësinë dhe kategoritë e aseteve me 4 korrik 2017. KEDS-i ka qenë e vetmja palë që ka dhënë komente në raportin për Jetëgjatësinë e Aseteve. Komentet e KEDS-it janë publikuar në ueb faqen e ZRRE-së së bashku me këtë raport.

Ky Raport i Përgjigjeve përmbledh komentet e pranuar nga KEDS-i rreth Jetëgjatësisë dhe kategorive të propozuara të Aseteve për Periudhën Rregullative PRR2 dhe përgjigjet e ZRRE-së ndaj tyre.

Pas publikimit të këtij raporti, Bordi i ZRRE-së do të shqyrtojë dhe do të bëjë përcaktimin përfundimtar të Jetëgjatësisë së Aseteve që do të përfshihen në llogaritjen e MAR për OSSH dhe OST në Periudhën Rregullative të PRR2.

Dokumentet relevante

LIGJI Nr. 05/L - 085 për Energjinë Elektrike	http://ero-ks.org/2016/Ligjet/LIGJI_PER_ENERGJINE_ELEKTRIKE.pdf
LIGJI Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë	http://ero-ks.org/2016/Ligjet/LIGJI_PER_RREGULLATORIN_E_ENERGJISE.pdf



Rregulla për të Hyrat e OST/OT	http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OST_OT.pdf
Rregulla për të Hyrat e OSSH	http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hyrat%20e%20OSSH.pdf
Raporti Konsultativ i ZRRE-së	http://ero-ks.org/2017/Tarifat/Raport_Konsultativ_per_jetegjatesine_e_aseteve_04072017.pdf
Komentet e KEDS-it në Raportin Konsultativ	http://ero-ks.org/2017/Tarifat/Komentet%20ndaj%20Raportit%20Konsultative%20t%C3%AB%20ZRRE%20per%20jetegjatesin%20e%20aseteve_KEDS.pdf

2 Jetëgjatësia dhe kategoritë e Aseteve të OSSH

2.1 Përmbledhja e komenteve të KEDS-it

Në komentet e veta, KEDS-i ka dhënë argumentet në vijim:

- KEDS-i propozon që një kategori re e asetëve të listohet për rrjetin e Tensionit të Ulët (TU) dhe pajisjeve të saj përkatëse. Propozimi i KEDS-it është që rrjeti i TU zhvlerësohet me një ritëm më të shpejtë se sa rrjeti i Tensionit të Mesëm (TM). Prandaj, KEDS-i propozon një jetëgjatësi më të shkurtë të asetëve prej 20 vjetësh të zbatohet për kategorinë e propozuar të asetëve të TU.
- KEDS-i propozon që një kategori i re e asetëve të përfshihet për pajisjet matëse. KEDS thekson se jetëgjatësia e asetëve të njehsorëve dhe pajisjeve matëse duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit të Matjes i cili sipas KEDS kërkon që pajisjet matëse të kalibrohen çdo tetë vjet.
- KEDS-i propozon që jetëgjatësia e asetëve të pajisjeve dhe orendive të zyrave të zvogëlohet në 5 vjet, krahasuar me propozimin aktual të ZRRE-së prej 7 vjetësh.
- KEDS-i gjithashtu propozon që jetëgjatësia e asetëve të TI dhe softuerëve të zvogëlohet në tri vjet krahasuar me propozimin aktual të ZRRE-së prej 5 vjetësh. Argumenti i KEDS-it është që softueri duhet të jetë i përditësuar me kërkesat e ndryshuara të sistemeve energjetike.
- Ajo që është më e rëndësishmja, KEDS-i propozon që kategoritë e reja të propozuara të zbatohen edhe për asetet ekzistuese. Ndonëse KEDS-i pranon se kjo është një punë e rëndë, ata theksojnë se me kapacitet njerëzore dhe burimet e TI që ka KEDS-i në dispozicion kjo mund të bëhet. KEDS-i thekson se kjo u mundëson palëve që të rishikojnë dhe krahasojnë jetëgjatësinë e asetëve dhe të rrisin transparencën në Bazën e Rregulluar të Asetëve.



2.2 Përmbledhja e komenteve të KOSTT-it

KOSTT pas analizimit të propozimeve e dala nga Raporti Konsultativ jetëgjatësinë dhe kategoritë aseteve është pajtuar me vlerësimet e ZRRE-së, përveç shtyllave të cilat duhet të jenë në një kategori me rrjetin e tensionit të lartë, të cilat janë shprehur nga KOSTT gjatë diskutimeve.

Në këtë raport, ZRRE-ja shqyrton propozimet e KEDS-it dhe KOSTT-it në lidhje me jetëgjatësinë dhe kategorizimin e aseteve. Konkluzionet e ZRRE-se janë të dhëna në fund të këtij raporti.

3 Pozicioni i ZRRE-së për komentet e KEDS-it

3.1 Jetëgjatësia e aseteve të Tensionit të Ulët

Politikat rregullatore dhe vlerësimet kontabël për jetëgjatësinë dhe zhvlerësimin e aseteve materiale përveç që bazohen në Standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit, përvojat ndërkombëtare të rregullatorëve, merren në konsideratë edhe metodat e krahasimit me kompani të ngjashme (benchmarking).

ZRRE ka analizuar me kujdes propozimin e KEDS-it dhe në bazë të të dhënave dhe informatave të siguruara, pajtohet që të kemi një kategori tjetër për rrjetin TU dhe pajisjet e tij përkatëse dhe jetëgjatësia e aseteve të jetë 25 vjet. Në bazë të matjeve dhe studimeve është vlerësuar nga kompani dhe rregullator se jetëgjatësia e kablove është 20-40 vjet, ndërsa e transformatorëve 25-30 vjet.

ZRRE-ja pajtohet që të kemi edhe një kategori të re të aseteve “kategoria III”, ku do të përfshihen: Rrjetet TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet me jetëgjatësi prej 25 vjetësh.

3.2 Jetëgjatësia e aseteve të njehsorëve dhe pajisjeve matëse

ZRRE me qëllim të vlerësimit më të drejt të këtij inputi, pas publikimit të Raportit Konsultativ për Kategoritë e aseteve dhe Jetëgjatësinë e aseteve, ka kërkuar nga KEDS Sh.a informata shtesë lidhur me jetëgjatësinë e njehsorëve sipas llojit të tyre ashtu siç specifikohet nga prodhuesi.

KEDS sh.a ka dërguar në ZRRE tabelën e detajuar për jetëgjatësinë e njehsorëve, koston e ndërlidhur të kalibrimit dhe koston e nderimit të baterisë. Gjithashtu ka bashkangjitur kërkesat e MTI për kalibrimin e njehsorit “Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr.02/2015” për periudhën verifikuese të mjeteve matëse ligjore, mënyra e zbatimit si dhe periudhat Ri-kalibruese për etalonët të cilët përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjore.

ZRRE ka analizuar të dhënat e ofruara nga KEDS, ku jetëgjatësia e njehsorëve varësisht nga lloji dhe prodhuesi (ACTARIS, ISKRA, ZPA, LUNA, LANDIS+GYR) është 15-20 vjet. Jetëgjatësia e baterisë është tek pjesa e më e madhe e prodhuesëve 10 vjet, por ka bateri te disa prodhues me jetëgjatësi 15-20 vjet. Sa i përket validitetit të rikalibrimit sipas Udhëzimin Administrativ (MTI) Nr.02/2015, rikalibrimi duhet të bëhet çdo 8 vjet me përjashtim të njehsorëve indirekt (HI/I dhe HI) të prodhuesit Iskra dhe LANDIS+GYR ku kërkohet rikalibrimi çdo 6 vjet.



ZRRE-ja mban qëndrimin e njëjtë sikur në Raportin Konsultativ ku njehsorët do të kenë jetëgjatësi prej 10 vjet dhe argumente në lidhje me kalibrimin nuk i konsideron si të bazuara, pasi që ato nuk përfshihen në kategorinë e shpenzimeve të zhvlerësimit.

3.3 Jetëgjatësia e aseteve të pajisjeve dhe orendive për zyre

KEDS nuk ka dhënë argumente bindëse për uljen e në 5 vjet të jetëgjatësisë për kategorinë e mobileve dhe orendive të zyrës, prandaj ZRRE do të ruaj qëndrimin e saj të paraqitur në raportin konsultativ ku do kjo kategori do të ketë jetëgjatësi prej 7 vitesh. Një vendim i tillë është i bazuar edhe në kategorizimin e jetëgjatësisë së tyre nga institucionet publike.

Duhet theksuar që KOSTT është pajtuar me qëndrimin e ZRRE-së dhe do të mbahet një qëndrim konsistent për sektorin e energjisë.

3.4 Jetëgjatësia e aseteve të pajisjeve të TI

ZRRE do të ruaj qëndrimin e saj në lidhje me jetëgjatësinë e aseteve të TI, duke u bazuar në jetëgjatësinë teknike të rekomanduar nga prodhuesit, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit si dhe vlerësimet e rregullatorëve. Për më tepër KEDS nuk ka ofruar argumente për një jetëgjatësi më të ulët, ndërsa KOSTT është pajtuar me propozimin e ZRRE-së.

Prandaj, ZRRE-ja propozon që të vazhdohet me jetëgjatësinë e pajisjeve të TI prej 5 vjetësh.

3.5 Rishikimi i jetëgjatësisë së aseteve ekzistuese

Ndryshimi i jetëgjatësisë së një baze ekzistuese të aseteve, do të ishte një proces tepër kompleks dhe jo konsistent me qëndrimet e vazhdueshme të ZRRE në lidhje me parimet themelore të rregullimit. Përcaktimet e PRR1 janë bërë me një proces transparent duke u konsultuar me të licencuarit dhe publikun, prandaj ZRRE nuk sheh asnjë arsye që të ndryshoj një vendim i cili është marrë në këtë mënyrë. Për më tepër ZRRE me Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit ka sqaruar këtë çështje ku citohet: *“Me qëllim të llogaritjes së bazës së rregulluar të aseteve, të licencuarit mund të llogarisin zhvlerësimin e shpenzimeve kapitale të ndërlidhur me periudhat e mëparshme rregullative duke shfrytëzuar një jetëgjatësi mesatare të mbetur të aseteve për secilën kategori të aseteve, në vend të mbajtjes së zhvlerësimit në baza vjetore sipas shpenzimeve kapitale historike. Gjatë llogaritjes së mesatares së jetëgjatësisë së mbetur të aseteve për secilën kategori të aseteve, i licencuari duhet të sigurohet që vlera e zhvlerësimit të lejuar për periudhë rregullative të jetë e pandryshuar”*.

ZRRE propozon që të mos pranohet propozimi i KEDS në lidhje me asetet ekzistuese.

4 Pozicioni i ZRRE-së për komentet e OST/OT

ZRRE ka pranuar nga KOSTT një dokument të përmbledhur të komenteve për të gjitha vlerat hyrëse, ku në lidhje me jetëgjatësinë e aseteve është pajtuar në shumicën e qëndrimeve të ZRRE-së.



ZRRE ka shqyrtuar komentimin e vetëm të KOSTT-it në lidhje me kategorizimin e shtyllave dhe e propozon që të pranohet komenti si i bazuar duke i vendosur “shtyllat” në kategorinë rrjetit të Tensionit të Lartë (kategoria II-të) të cilat do të kenë jetëgjatësi prej 40 vjetësh.

5 Propozimi i Jetëgjatësisë dhe kategorizimit të aseteve për OST/OT dhe OSSH

ZRRE-ja pas analizimit të komenteve të pranuar nga KEDS dhe KOSTT ka përcaktuar vlerat hyrëse për Kategorizimin e aseteve dhe jetëgjatësinë e aseteve për Periudhën Rregulative të PRR2.

Kategoritë e propozuara të aseteve dhe jetëgjatësia e tyre janë të paraqitura në tabelat më poshtë.

Tabela 1: Kategoritë e aseteve të transmisionit dhe jetëgjatësia e tyre të propozuara për KOSTT

Asetet		Jetëgjatësia e asetit (vjet)
I	Ndërtesat, rrugët, rrjetet e kanalizimeve, furnizimi me ujë, puset, ashensorët	50
II	Rrjeti i TL, shtyllat	40
III	Rrjeti i tensionit të ulët, nënstacionet, transformatorët, etj.	30
IV	Kamionet, korpa dhe makineri për punë	10
V	Kontrolli dhe Telekomunikimi, pajisje të ndryshme, mbrojtja nga zjarri	8
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e TI, softuerë, patente, licenca, vetura, etj.	5

Tabela 2: Kategoritë e aseteve të shpërndarjes dhe jetëgjatësia e tyre të propozuara për KEDS

Asetet		Jetëgjatësia e asetit (vjet)
I	Ndërtesat e administratës	50
II	Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	30
III	Rrjetet e TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	25
IV	Stacionet e transformatorit (TMRR dhe TMT) ¹ dhe pajisjet	15
V	Njehsorët dhe pajisjet matëse, Kamionet, korpa dhe makineri për punë	10
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët , pajisjet TI, softuerë, mobilet, pajisjet për zyrë	5

¹ TMRR dhe TMT janë transformatorët mates të rrymës dhe tensionit